



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI**

Nr. 827/2 Prot.

Tiranë, më 28 . 05 . 2026

V E N D I M

Nr. 141, datë 28 . 05 . 2026

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar ¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 114 Regj., datë 05.05.2026, të shtetases M. K³, kundër Kontrollit të Lartë të Shtetit, me pretendimin e diskriminimit për shkak të “gjinisë”, “shtatzënisë” dhe “përgjegjësisë prindërore”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Referuar parashtimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga subjekti ankues, M. K, pranë KMD-së, evidentohet se, më datë 24.11.2014, është punësuar pranë KLSH në pozicionin e punës “Audituese e Dytë”, pranë Departamentit të Auditimit të Performancës, e më pas pranë Departamentit të Auditimeve të Institucioneve Qendrore, pozicion të cilin e ka mbajtur deri në muajin vitin 2016.

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD ose si Komisioneri.

³ Përfaqësuar me Prokurë të Posaçme me nr. rep. 8006, nr. kol. 3342, datë 10.10.2024, nga av. J. B, i cili e përfaqëson edhe para KMD-së.

Në vijim, në këtë vit 2016, ankuesja u ngrit në detyrë në kategorinë “Audituese e Parë” pranë Departamentit të Auditimeve të Institucioneve Qendrore. Më pas, pas vlerësimeve të larta nga eprori në kryerjen e detyrave të saj, në Korrik të vitit 2020, ankuesja u ngrit në detyrë në kategorinë “Audituese e Lartë”, po në Departamentin e Auditimeve të Institucioneve Qendrore, me kategori page II, Klasa II-2.

Në shtator të vitit 2020, ankuesja mori leje lindje për fëmijën e parë. Gjatë kohës që ankuesja ishte ende me leje lindjeje, fëmija u diagnostikua me sindromën FPIES (food protein induced enteritis syndrome) e cila është një sëmundje e aparatit të tretjes që mund të rëndohet në mënyrë të menjëhershme nga disa faktorë të jashtëm, si dhe nga ushqime të ndryshme dhe mund të shkaktojë alergji azmatike.

Në këto kushte, ankuesja, i kërkoi me shkrim Kryetarit të KLSH, pezullimin e marrëdhënies së shërbimit civil për një afat 1 vjeçar nga data 28.07.2021 në të cilën përfundon leja e lindjes, deri më datë 27.07.2022.

Kryetari i KLSH, me vendimin Nr. 663/2 Prot., datë 10.06.2021 vendosi pranimin e kërkesës dhe pezullimin ankueses nga pozicioni i Auditueses së Lartë për një periudhë 1 vjeçare nga data 28.07.2021 deri më 27.07.2022, për arsye shëndetësore të njerëzve të afërt të saj, të vërtetuar me raportin mjekësor të datës 12.05.2021.

Për shkak të gjendjes mjekësore të djalit të ankueses, i cili u shtrua në spital me bronkopneumoni për shkak të komplikacioneve nga COVID-19, ajo iu drejtua Kryetarit të KLSH me kërkesë për zgjatjen me një vit, të afatit të pezullimit nga i njëjti pozicion. Kërkesa u pranua dhe iu njoftua ankueses me shkresën e Drejtoreshës së Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të KLSH, Nr. 724/1 Prot., datë 26.07.2022. Nëpërmjet kësaj shkrese, afati i pezullimit u shty deri më datë 26.07.2023.

Rezulton se me vendim të Kryetarit të KLSH, dhe pa kundërshtim të ankueses, kjo e fundit u transferua në Departamentin e Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional, Sektori i Metodologjisë dhe Zhvillimit, pa ndryshuar kategorinë “Audituese e Lartë”. Në përfundim të afatit të pezullimit, ankuesja u paraqit rregullisht në punë duke zhvilluar detyrat e saj në departamentin e ri si Audituese e Lartë, me pagë mujore bruto prej 162,068 lekë.

Më datë 04.09.2023, ankuesja fillon lejen e lindjes për fëmijën e dytë i cili lindi më 24.09.2023. Leja e lindjes përfundonte në 19.08.2024, datë nga e cila ankuesja do të kthehej në punë rregullisht.

Pa pasur asnjë njoftim apo komunikim tjetër paraprak të çfarëdolloji, më datë 31.07.2018, ndërkohë që Ankuesja ishte ende me leje lindjeje, ankuesja u njoftua me e-mail lidhur me vendimin e Kryetarit të KLSH, Nr. 818/19 Prot., Datë 30.07.2024 me lëndë: “Ndryshim kategorie dhe departamenti” Në vijim referuar si “Vendimi Nr. 818”.

Ankuesja u ul në kategorinë që kishte mbajtur para 10 vjetësh, iu ul rroga në mënyrë drastike, si dhe u transferua në Sektorin e Auditimit të Njësive Vendore të Nivelit të Dytë, e cila në shumicën dërrmuese të rasteve, kryen auditime jashtë Tiranës.

Meqenëse Vendimi i mësipërm ndryshonte në mënyrë drastike të gjitha kushtet e punës dhe pagën e ankueses, dhe meqenëse e gjitha kjo u krye ndërkohë që ankuesja ishte me leje lindjeje, ankuesja njoftoi Kryetarin e KLSH dhe Drejtorinë e Burimeve Njerëzore se nuk ishte dakord me Vendimin Nr. 818 dhe e konsideronte si të pabazuar në ligj.

Në përgjigje të shkresës së mësipërme, nuk pati asnjë reagim as nga Kryetari i KLSH e as nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

Në vijim, Drejtoria e Burimeve Njerëzore e KLSH i dërgoi ankueses një e-mail datë 02.09.2024, nëpërmjet të cilit i kërkonte ankueses sqarim lidhur me mosparaqitjen e saj në punë pas përfundimit të lejes së lindjes.

Ankuesja u njoftua për shkresën e Komisionit Disiplinor pranë KLSH, Nr. 1118/11 Prot., datë 24.09.2024 me lëndë “Njoftim për fillim ecurie disiplinore”, për shkak të mosparaqitjes në punë.

Në takimin që u mbajt pranë të KLSH lidhur me këtë procedim disiplinor, përfaqësuesi i ankueses parashtroi se ankuesja është pushuar nga puna më datë 01.08.2024, datë në të cilën hynte në fuqi Vendimi Nr. 818, dhe nuk kishte se si të vinte në punë kur nuk ka qenë dakord me caktimin tërësisht të paligjshëm të punës së re, me pagë më të ulët, me kushte tërësisht të pafavorshme për një nënë me një fëmijë në gji, me ulje në dy kategori, të gjitha këto ndërkohë që ishte me leje lindjeje. Këtij pretendimi, në takimin e zhvilluar, anëtarët e komisionit disiplinor u munduan t’i shmangeshin duke thënë vetëm se kjo është një çështje tjetër.

Kryetari i KLSH nëpërmjet Vendimit nr. 1276/1 Prot., datë 23.10.2024 vendosi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ankuesen më datë 30.10.2024 si dhe u lëshua Vendimi i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të KLSH Nr. 1276 Prot., datë 23.10.2024 me lëndë “Vendim për lirim nga shërbimi civil”.

Përfaqësuesi ligjor i subjektit ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi: Konstatimin e diskriminimit të ankimeses nga KLSH, për shkak të gjinisë, shtatzënisë dhe përgjegjësisë prindërore si pasojë e:

Vendimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit Nr. 818/19 Prot., Datë 30.07.2024 me lëndë: “Ndryshim kategorie dhe departamenti”;

Vendimit të Komisionit Disiplinor të KLSH Nr. 1118/29 Prot., datë 22.10.2024;

Vendimit të Kryetarit të KLSH Nr. 1276/1 Prot., datë 23.10.2024;

Vendimit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të KLSH Nr. 1276 Prot., datë 23.10.2024 me lëndë “Vendim për lirim nga shërbimi civil”;

Kthimin e Ankueses në pozicionin e mëparshëm të punës “Audituese e Lartë” pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit me kategori page II, Klasa II-2, ose në një pozicion ekuivalent të të njëjtës kategori, brenda shërbimit civil;

Detyrimin e KLSH që t’i paguajë ankimeses si dëmshpërblim pagën e plotë si “Audituese e Lartë” në masën 162,068 lekë në muaj nga data 19.08.2024 deri në rikthimin në të njëjtin pozicion pune; Dënimin me gjobë të subjekteve shkelëse të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit paraprak që Komisioneri i ka bërë parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga pala ankuese, ka rezultuar se:

Pjesë e dokumentacionit të dërguar pranë KMD-së, është dhe kërkesë-padia drejtuar me paditës: subjektin ankues, M. K dhe subjekt të paditur, ish-punëdhënësin, Kontrollin e Lartë të Shtetit (KLSH).

Bazuar në parashtrimet dhe dokumentacionin e depozituar nga pala ankuese në këtë proces, Komisioneri vëren se, në analizë të kërkesë-padisë së ankuesit drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (në vijim Gjykatës), rezulton se pretendimi i ngritur nga subjekti ankues për diskriminim në marrëdhëniet e punës, për shkaqet e pretenduara, është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor.

Theksojmë se, të njëjtat fakte dhe rrethana janë paraqitur edhe përpara Komisionerit. Po ashtu të njëjtat shkaqe të elaboruara që bëhen prezent në kërkesë-padinë e paraqitur para Gjykatës, janë pretenduar dhe tek Komisioneri.

Komisioneri konstaton se, në objekt të kërkesë-padisë drejtuar Gjykatës, ankuesi kërkon “Objekti”:

- “Shfuqizimi i Vendimit të Komisionit Disiplinor të KLSH Nr. 1118/29 Prot., datë 22.10.2024.
- Shfuqizimi i Vendimit të Kryetarit të KLSH Nr. 1276/1 Prot., datë 23.10.2024.
- Shfuqizimi i Vendimit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të KLSH Nr. 1276 Prot., datë 23.10.2024 me lëndë “Vendim për lirim nga shërbimi civil”

- *Kthimi i Paditëses në pozicionin e mëparshëm të punës “Audituese e Lartë” pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit me kategori page II, Klasa II-2, ose në një pozicion ekuivalent të të njëjtës kategori, brenda shërbimit civil.*
- *Detyrimi i palës së Paditur që t’i paguajë Paditëses pagën e plotë si “Audituese e Lartë” në masën 162,068 lekë në muaj nga data 19.08.2024 deri në rikthimin në të njëjtin pozicion pune.*
- *Detyrimi i palës së Paditur t’i paguajë Paditëses shpenzimet gjyqësore dhe avokatore.*
- *Dhënia e vendimit gjyqësor me ekzekutim të përkohshëm.”*

Në kërkesë-padinë e depozituar para Gjykatës, konstatohet se, në parashtrimet e bëra nga subjekti ankues, në cilësinë e paditësit, kundër të paditurit, KLSH-së, ndër të tjera, citohet se:

“... vendimet për largimin e Paditëses nga puna nuk janë çështje të ndara, por janë pjesë e praktikës antiligjore dhe tërësisht diskriminuese ndaj paditëses, në shkelje të çdo ligji e parimi të zbatueshëm, të nisura me Vendimin 818, që më datë 31.07.2024, datë kur u mor ky vendim.

.....

Konkretisht, Kodi i Punës parashikon detyrimet për punëdhënësin, pra të Paditurin, që kur gruaja me fëmijë në gjë rikthehet në punë, punëdhënësi merr masat e nevojshme për të siguruar përshtatjen e përkohshme të kushteve të punës dhe/ose të orëve të punës, me qëllim që të shmangë çdo rrezik ndaj punëmarrëses dhe/ose fëmijës (Neni 104) dhe që, me mbarimin e lejes së lindjes, të rikthejë punëmarrësin në vendin e mëparshëm të punës ose në një vend pune të barasvlefshëm, në kushte që nuk janë më pak të favorshme për të, ndërkohë që siç rezulton nga sa sipër, i Padituri vendosi të transferojë Paditësen pa asnjë arsye dhe pa u kthyer ende nga leja e lindjes, duke përkeqësuar absolutisht të gjitha kushtet e punës, siç janë paga, vendi i ushtrimit të detyrës nëpër institucione vendore larg Tiranës, dhe lloji i punës shumë më voluminoz se ai që kryente në departamentin ku ishte përpara se Paditësja të merrte lejen e lindjes”.

Bazuar në analizën e parashtrimeve të kërkesë-padisë paraqitur para Gjykatës, ankuesja, ka pretenduar *inter alia*, trajtimin e padrejtë, të pafavorshëm dhe diskriminues në marrëdhëniet e punës, lidhur me transferimin dhe lirimimin e saj nga shërbimi civil, dhe ka kërkuar, ndër të tjera edhe “*rikthimin në të njëjtin pozicion pune ose në një pozicion ekuivalent të të njëjtës kategori, brenda shërbimit civil*”, duke investuar kështu edhe Gjykatën për të njëjtat pretendime dhe shkaqe që ka sjellë paralelisht edhe pranë KMD-së.

Në Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr. 03, datë 29.03.2012, i cili bën fjalë për objektin dhe shkakun ligjor të padisë, citohet: “*...Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin se për të vlerësuar objektin e padisë është e nevojshme të shihet kërkesëpadia në përmbajtje të saj, të gjitha shtjellimet e kërkimet e paditësit dhe jo vetëm pjesa hyrëse e kërkesëpadisë. Natyrisht që palët kanë detyrimin që të paraqesin pretendime të qarta dhe të kuptueshme për palën tjetër dhe gjykatën, por jo domosdoshmërisht objekti i padisë gjendet gjithnjë vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë (pavarësisht se në praktikë vërehet një konstante në këtë drejtim). Objekti i padisë përmbledh në vetvete të gjitha pretendimet e palës të parashtruara*

në aktin procedural të kërkesëpadisë. Ai mund të përmbajë një kërkim ose disa të tillë, ndaj kur vlerësohet se çfarë padie është paraqitur për gjykim, gjykatat nuk duhet të kufizohen vetëm tek pjesa hyrëse e kërkesëpadisë, por duhet të shohin tërësinë e përmbajtjes së saj. Kjo pasi zakonisht në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë vendosen kërkimet bazë në formë të përmbledhur. Një pjesë e kërtimeve të padisë gjendet në pjesët përshkruese dhe shpjeguese të saj, e një pjesë tjetër mund të gjendet në pjesën fundore të kërkesëpadisë.”

Neni 33, pika 7/4, e ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikon se: “Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatim diskriminimi, ndërkohë që ka paraqitur të njëjtën ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për pushimin e çështjes.”

Në këtë kontekst, në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata, bazuar në sa më sipër, si dhe në paragrafin 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se: “...Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata...”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet, lidhur me ankesën me nr. 114 Regj., datë 05.05.2026, të M. K, dhe deklaroi pushimin e shqyrtimit të saj⁴.

Bazuar në nenin 36, pika 4, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në rastin kur Gjykata e kërkon atë⁵, përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 36 të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe referuar nenit 32, pika 1, shkronja a), nenit 33, pika 7/4, dhe nenit 36/4, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

⁴ Për analogji shih vendimet me: nr. 13, datë 28.01.2021; nr. 27, datë 16.02.2021; nr. 77, datë 07.05.2021; nr. 230, datë 25.11.2021; nr. 253, datë 28.12.2021; nr. 77, datë 21.04.2022; nr. 108, datë 20.06.2023; nr. 145, datë 26.07.2023; nr. 89, datë 03.04.2024; nr. 25, datë 30.01.2025; nr. 269, datë 26.11.2025, nr. 20, datë 02.02.2026, nr. 44, datë 26.02.2026, të Komisionerit.

⁵ Ose me kërkesë drejtuar Gjykatës, të palës së interesuar në procesin gjyqësor të iniciuar.

1. Pushimin e shqyrtimit të ankesës nr. 114 Regj., datë 05.05.2026, të paraqitur nga subjekti ankues, M. K, për shkak se çështja është duke u gjykuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Genta Tafa (BUNGO)